

MARREVEESHJE BASHKIMI ME PERTHITHJE

E shoqerise "ALBAS" sh.p.k me shoqerine "ALBAS OFFICE" sh.p.k

Kjo marreveshje Bashkimi me perthithje eshte hartuar ne perputhje me Nenin 216 dhe 225 te Ligjit Nr.9901, dt.14.04.2008 " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare"

Bashkimi me perthithje eshte iniciuar nga ortakët e shoqerise Albas shpk, per realizimin e procesit te bashkimit me perthithje te shoqerose Albas Office shpk nga shoqeria Albas shpk.

Shoqeria "ALBAS OFFICE" sh.p.k me Kapital 14.000.000 leke, i ndare ne 100 kuota me vlere nominale 1000 leke/kuota dhe zoterohet nga ortakët:

- ALBAS shpk 100% te kapitalit themeltar.

PERKUFIZIME DHE INTERPRETIME

Ne kete Marreveshje Bashkimi pervecse kur kuptohet ndryshe ose kur cilesohet ndryshe me tej, fjalet e meposhtme do te kene kuptimet e meposhtme:

"Marreveshje Bashkimi" nenkupton **Marreveshje Bashkimi**

"Shoqeria perthithese" do te jete **Shoqeria "ALBAS" sh.p.k**

"Shoqeria e perthithur" do te jete **Shoqeria "ALBAS OFFICE" sh.p.k**

"Data e Realizimit Perfundimtar te Bashkimit" (Data efektive e bashkimit)qe do te thote data e miratimit te Projekt Mareveshjes nga ortakët e shoqerise Albas shpk dhe ortaku I vetem I shoqerise ALBAS OFFICE shpk dhe I depozitimit te ketyre dokumentave ne Qendren Kombetare te Regjistrimit .

Data e Bashkimit do te thote data 01.01.2019

Ne lidhje me kete bashkim te dy shoqerite kane rene dakort si me poshte vijon:

1. BASHKIMI KEMBIMI I KUOTAVE

- 1.1 Ne baze te kushteve te Projekt mareveshjes Albas shpk do te perthithe shoqerine Albas Office shpk ne daten e Realizimit perfundimtar te Bashkimit (Data e fektive e bashkimit) qe eshte data e Miratimit te Projekt mareveshjes nga ortaku I vetem I shoqerise Albas shpk.
- 1.2 Albas Office shpk do ti transferoje shoqerise Albas shpk teresine e elementeve te aktivitet dhe te pasivitet duke perfshire edhe ato qe rezultojne nga operacionet e kryera gjate periudhes ushtrimore deri ne Daten efektive te Bashkimit.
- 1.3 Si rezultat I operacionit te bashkimit kapitali themeltar i shoqerise Albas shpk ne Daten Efektive te Bashkimit eshte 346.112.000 leke, si rezultat i konsolidimit te dy bilanceve, i cili ndahet ne dy kuota me vlere 173.056.000 secila.
- 1.4 Data e bashkimit eshte data 31.12.2018 qe do te thoe se te gjitha dhe cdo operacion i kryer nga Albas Office qe nga data 01.01.2019 deri me daten e regjistrimit perfundimtar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit do te konsiderohet si e kryer nga Albas shpk.
- 1.5 Statuti i shoqerise Albas shpk, mbas ndryshimeve qe mund ti behen Objektivitet te Veprimtarise do te vazhdoje te jete edhe Statuti i Shoqerise Perthithese.

1.6 Administrator i shoqerise perthithese Albas shpk do te vazhdoje te jete Znj. Rita Petri, e cila do te ushtroje kompetencat e shoqerise se bashkuar sipas Ligjit dhe Statutit te shoqerise.

2. AKTIVET DHE DETYRIMET E PARASHIKUARA PER TU TRANSFERUAR

Ne kuadrin e ketij operacioni bashkimi parashikohet qe Albas Office shpk ti transferoje shoqerise Albas shpk te gjithe elementet e Aktivit dhe Pasivit gjendje deri me 31.12.2018.

Shoqeria "ALBAS" sh.p.k

a) AKTIVE

-	Mjete monetare	53,791,877
-	Llogari te arketueshme	104,330,995
-	Inventari	137,556,455
-	Aktive afatgjata material	34,982,646
-	Aktivitet afatgjata jomateriale	2,803,200
-	Te arketueshme nga palet e lidhura	330,864,790
-	Te tjera te arketueshme	28,746,234
	Totali i Aktiveve	693,076,197

b) PASIVE

-	Detyrime afatshkurtra	30,920,862
-	Huat dhe parapagimet afatshkurtra	-
-	Detyrimet Afatgjata	-
	Totali i detyrimeve	30,920,862

Aktivi neto (a-b) (662,155,335)
leke.

Provizione per humbjet e priteshme nuk jane parashikuar.
Vlera kontabel e kontributit (662,155,335) leke.

Shoqeria "ALBAS OFFICE" sh.p.k

a) AKTIVE

-	Mjete monetare	4,662,195
-	Llogari te arketueshme	15,511,592
-	Inventari	21,052,065

-	Aktive afatgjata materiale	12,212,763
-	Aktivet afatgjata jomateriale	416,546
-	Te arketueshme nga palet e lidhura	
-	Te tjera te arketueshme	
	Totali i Aktiveve	53,855,161

b) PASIVE

-	Detyrime afatshkurtra	57,406,875
-	Huat dhe parapagimet afatshkurtra	-
-	Detyrimet Afatgjata	-
	Totali i detyrimeve	57,406,875

Aktivi neto (a-b) (-3,551,714) leke.

Provizione per humbjet e priteshme nuk jane parashikuar.

Vlera kontabel e kontributit (-3,551,714) leke

Modalitete

Ky operacion bashkimi nuk do te permbaje as te drejta dhe as ndonje avantazh te vecante.

Ky projekt bashkim hartohet e nenshkruhet me kushtin e varesise te miratimit nga asambleja e ortakeve te seciles prej shoqerive pjesemarrese.

Hartuar me 10/01/2019

Shoqeria perthithese
"ALBAS "sh.p.k
Administratori

Rita Petri



Stamp: REPUBLIKA E SHQIPERISE, Shqiperia Botuese, "ALBAS", SH.P.K., ALBANIA

Shoqeria e perthithur
"ALBAS OFFICE" Shpk
Administratori

Sevim Zendelli



Stamp: REPUBLIKA E SHQIPERISE, Shqiperia Botuese, "ALBAS OFFICE", SH.P.K., ALBANIA